



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT

Nr. 4985 Prot

Tiranë, më 02.05. 2024

URDHËR

Nr. 92 datë 02.05.2024

PËR

“PROCEDURËN E DORËZIMIT/PRANIMIT TË DOKUMENTEVE DHE RAPORTEVE TË VETËMONITORIMIT, PËR SUBJEKTET E PAJISUR ME VENDIM PËR VNM PARAPRAKE, DEKLARATË MJEDISORE, LEJE MJEDISI TË TIPIT A OSE B”

Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar, ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” i ndryshuar dhe Vendimi nr. 568, datë 17.07.2019 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit” i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Operatorët e pajisur me Vendim për VNM paraprake, Deklaratë Mjedisore, Leje Mjedisit të tipit A ose B, dorëzojnë dokumentat dhe raportet e vetëmonitorimit mbi zbatimin e kushteve të aktit, në protokollin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit me shkresë përcjellëse mbi dokumentacionin e paraqitur sipas pikës 3, në formatin CD.
2. Sektori i Monitorimeve të Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve pranë Drejtorisë së Shqyrtimit dhe Monitorimit të Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve, kontrollon dhe verifikon dokumentacionin dhe raportet e vetëmonitorimit në përputhje me kushtet e aktit të miratuar që disponon subjekti, si dhe përditëson regjistrin e dokumentacionit dhe raporteve të vetëmonitorimit sipas formatit të miratuar.
3. Lista e dokumentacioneve që dorëzohet nga operatorët e pajisur me Vendim për VNM paraprake / Deklaratë Mjedisore / Leje Mjedisit të tipit A ose B, është sipas Aneksit I dhe II, të këtij urdhëri.
4. Operatorët dorëzojnë dokumentacionin dhe raportet brenda 15 ditëve kalendarike nga data e miratuar në tabelën 12.1.1 të lejes mjedisore tipi B, në tabelën 6.1.1 të lejes mjedisore tipi A dhe në Aneksin II të Vendimit për VNM Paraprake / Deklaratë Mjedisore.

5. Sektori i Monitorimeve të Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve, kërkon plotësim të dokumentacionit apo informacion shtesë në rastet kur operatorët e pajisur me Vendim për VNM paraprake / Deklaratë Mjedisore / Leje Mjedisi të tipit A ose B, nuk kanë zbatuar kushtet e Aktit të Miratimit dhe nuk kanë dorëzuar dokumentacionin sipas Aneksit I dhe II, të këtij urdhëri.
6. Operatorët e pajisur me Vendim për VNM paraprake / Deklaratë Mjedisore / Leje Mjedisi të tipit A ose B në dokumentacionin vjetor mbi zbatimin e kushteve të lejes, dorëzojnë pranë AKM-së planin e mostrimit të miratuar nga operatori për parametrat e shkarkimit për vitin pasardhës, ku të përcaktohet data/muaji/viti/ora dhe vendi i marrjes së mostrave.
7. Operatorët e pajisur me Vendim për VNM paraprake / Deklaratë Mjedisore / Leje Mjedisi të tipit A ose B në rastet kur për përgatitjen e raporteve të vetëmonitorimit marrin mostra, së bashku me dokumentacionin sipas Aneksit I të këtij urdhëri përfshijnë në material dokumenta provues nga procesi i marrjes së mostrave (foto-video).
8. Operatorët së bashku me raportet e testimit/analizat që dorëzojnë pranë AKM-së bashkëlidhin dhe autorizimin për laboratorin e akredituar për marrjen e mostrës, testimin dhe analizimin e saj.
9. Kur dokumentacioni mbi zbatimin e kushteve periodike dhe vjetore nuk dorëzohet nga vetë operatori, personi i cili bën dorëzimin e dokumentacionit pranë AKM-së, paraqet autorizimin e përfaqësimit nga operatori për çdo raportim.
10. Sektori i Monitorimit të Lejeve Mjedisore dhe VNM pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në rastet kur dokumentacioni i kërkuar nuk është sipas kërkesave të këtij urdhëri, nuk pranon shqyrtimin e tyre dhe njofton menjëherë operatorin e lejes mjedisore si dhe laboratorin e autorizuar ose personin e autorizuar.
11. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Drejtoria e Shqyrtimit dhe Monitorimit të Lejeve Mjedisore dhe VNM-ve, pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

Ky urdhër hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas miratimit.

Me hyrjen në fuqi të këtij urdhëri, shfuqizohet urdhëri nr. 126, datë 10.06.2022.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Arta Dollani



ANEKSI 1. LEJET MJEDISORE TË A ose B

ZBATIMI I KUSHTEVE QË PLOTËSOHEN VETËM 1 HERË		
(3 mujori i parë i lejes)		
Nr.	Emërtimi i Dokumentit	Kushti i lejes mjedisore
1.	Masat e ndërmarra përpara vendosjes në funksionim të instalimit	1.5
2.	Plani i menaxhimit të mbetjeve	1.5
3.	Operimi dhe Infrastruktura	3
4.	Programi i Menaxhimit të Riskut	3.4.8
5.	Dokumenti i Vlerësimit të Riskut	3.4.8
6.	Plani i përputhshmërisë	4
7.	Interpretimi i vlerave të shkarkimeve	5
8.	Dokumentimi dhe Raportimi	12
9.	Regjistri i shkarkimit të ndotjes	12
10.	Programi i Monitorimit të Zhurmës	12
11.	Programi i Menaxhimit të Mjedisit	12
12.	Plani i mostrimit (për vitin aktual ushtrimor, për secilin 3 mujor apo 6 mujor raportimi)	12
13.	Plani i veprimit për veprimtaritë minerare me karrierë (guroret)	12 kur kërkohet
14.	Incidentet dhe veprimet gjatë emergjencave	13
15.	Politika dhe plani i parandalimit të aksidenteve	13
16.	Çmontimi, rehabilitimi dhe kontrolli pas ndërprerjes së operacioneve	14
17.	Plani i rehabilitimit të objektit mineral	14 kur kërkohet

ZBATIMI I KUSHTEVE PERIODIKE 3 OSE 6 MUJORE

Nr.	Emërtimi i Dokumentit	Kushti i lejes mjedisore
1.	Vendndodhja e ushtrimit të veprimtarisë	1.6
2.	Njoftimet	6
3.	Shkarkimet	7
4.	Plani i Menaxhimit të Tretësave Organik	7
5.	Inspektime Vizuale Ditore/Javore/Mujore për instalimet dhe shkarkimet në ajër, ujë, tokë, zhurmë, mbetje	7
6.	Mirëmbajtja/Plani i Shërbimeve	7
7.	Menaxhimi i Mbetjeve	8
8.	Plani i Menaxhimit të Mbetjeve	8
9.	Zhurmat dhe Vibracionet	9
10.	Monitorimi	11
11.	Dokumentimi dhe Raportimi	12
12.	RAPORTI PERIODIK I MONITORIMIT	12

ZBATIMI I KUSHTEVE VJETORE

Nr.	Emërtimi i Dokumentit	Kushti i lejes mjedisore
1.	Dokumentacioni lidhur me menaxhimin e përbërësve të mjedisit për instalimin/impianin	2
2.	Programi i Menaxhimit të Mjedisit	2.9.2
3.	Regjistri i Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotjes - Raport për vitin paraardhës	2.9.2
4.	Regjistri i Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotjes - Propozim për vitin aktual ushtrimor	2.9.2

5.	Raport përmbledhës mbi rezultatet për monitorimin e zhurmës	2.9.2
6.	Përshkrimi i Monitorimit të Mjedisit	2.9.2
7.	Përshkrimi i Incidenteve/Aksidenteve	2.9.2
8.	Raport përmbledhës për Auditimin e Eficencës së Energjisë	2.9.2
9.	Raport për vlerësimin e Eficencës së shfrytëzimit të lëndëve të para dhe reduktimin e gjenerimit të mbetjeve	2.9.2
10.	Menaxhimi i Mbetjeve	2.9.2
11.	Raport përmbledhës për Auditimin e Eficencës së Ujit	2.9.2
12.	Deklaratë mbi masat për parandalimin e ndotjes së mjedisit dhe veprimet e rehabilitimit	2.9.2
13.	Programi i Menaxhimit të Riskut	2.9.2
14.	Plani i përputhshmërisë	2.9.2
15.	Plani i çmontimit ose rehabilitimit	2.9.2
16.	Lëndët e para dhe shfrytëzimi i energjisë	10
17.	Plani i mostrimit (për vitin pasardhës, për secilin 3 muaj apo 6 muaj raportimi)	12
18.	Dokumentimi dhe Raportimi	12
19.	Raport mbi ankesat	
20.	Incidentet dhe veprimet gjatë emergjencave	13
21.	Çmontimi, rehabilitimi dhe kontrolli pas ndërprerjes së operacioneve	14
22.	RAPORTI VJETOR I MONITORIMIT	

ANEKSI II. VENDIM PËR VNM PARAPRAKE / DEKLARATË MJEDISORE
ZBATIMI I KUSHTEVE PERIODIKE

Nr.	Emërtimi i Dokumentit
1.	Informacion në momentin e fillimit të punimeve
2.	Informacion për menaxhimin e mbetjeve inerte
3.	Informacion në përfundim të punimeve, lidhur me punimet rehabilituese të territorit përreth, shoqëruar edhe me foto
4.	<p>Raportimin periodik për parametrat që do të monitorohen sipas datës dhe periudhës së raportimit të Vendimit / Deklaratës, si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Zhurma dhe Vibracionet në:<ul style="list-style-type: none">• Automjete/kamiona në hyrje të kantierit• Kantier ndërtimi• Mjedisi urban më i afërt me kantierin2. Shkarkimet në ajër<ul style="list-style-type: none">• Lënda grimcore (PM2.5)• PM103. Cilësia e ujrave<ul style="list-style-type: none">• Lëndët në pezulli